



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 18.02.2015, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Mungoi : Ylli Hoxha, shef i GP të LVV-së.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesi i OJQ-ve, përfaqësuesi nga Zyra për marrëdhënie me publikun dhe përfaqësuesit e mediave. Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

REND DITE:

1. Propozimbuxheti për vitin 2015.

Mbledhjen e hapi **kryesuesi** i Komitetit, z. Halim Hallimi. Ai tha se kjo është mbledhje e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa për propozimbuxhetin e vitit 2015.

Visar Berisha dha sqarime lidhur me buxhetin e vitit 2015, duke thënë se buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2015 do të jetë 62,706,756 €.

Planifikimi për të hyrat vetjake të Komunës për vitin 2015, është 27,162,609 €.

Në të hyrat vetjake ka ndryshim nga buxheti i kaluar, ndërsa subvencionet dhe transferet janë si në buxhetin e kaluar. Te projektet kapitale hiqet nga një përqindje e vogël, pa u dëmtuar ato projekte kapitale.

Kryesuesi kërkoi që të bëhet emërtimi i saktë i vendbanimeve (sipas ligjit).

Sami Hamiti bëri të ditur se vërejtja e Grupit të LDK-së ka qenë për planifikimin e të hyrave vetjake, sepse janë jashtë mundësive të kapaciteteve që i ka Komuna.

Te shpenzimet kapitale, kërkoi që pjesa 1.4.2 dhe 1.4.3, të specifikohen dhe të sillen në Kuvend ajo pjesë përcjellëse. Si dokument është i punuare mirë, dhe në Kuvend duhet të dërgohet edhe pjesa përcjellëse.

Hatixhe Hoxha tha se vërejtjet do t'i japin në seancën e Kuvendit.

Lirak Çelaj shtroi pyetje lidhur me tërheqjen e buxhetit nga mbledhja e kaluar e KPF-së. Kërkoi shpjegim se si është bërë planifikimi në këtë buxhet për taksat komunale të ndërtimit. Ai u shpreh se në parim do ta përkrahin këtë buxhet, duke bërë plotësimin e disa mangësive.

Islam Pacolli u shpreh në përkrahje të buxhetit, por kërkoi që te investimet, te infrastruktura, të ketë specifikim më të qartë kur materiali të dërgohet në Kuvend, sepse nuk është e specifikuar mirë; për paga dhe mëditje, të dihet sa janë paga, e pastaj mëditjet, si dhe për taksat e ndërtimit të kenë një specifikim më të thukët kur ky material të sillen për shqyrtim në Kuvend.

Imer Rusinovci e përkrahu buxhetin, por kërkoi që të veçohen subvencionet në bujqësi.

Visar Berisha u përgjigj në pyetjet e parashtruara, duke thënë se pagat dhe mëditjet janë përcaktuar sipas ligjit, ndërsa sa i përket taksës për ndërtim, si Komunë jemi duke punuar me Ministrinë, por në buxhet si parim është marrë viti 2014.

Çështja e taksës për ndërtim është çështje specifike, këtë çështje ia lëmë Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Kryetarit.

Lirak Çelaj shprehu mendimin se është bërë gabim i madh që është hequr buxheti nga rendi i ditës së KPF-së dhe është bërë një paragjykim jo i drejtë nga Kryetari, sepse buxheti nuk është bllokuar.

Kryesuesi u pajtua me mendimin e z. Çelaj, se buxheti nuk është dashur të hiqet nga KPF-ja, sepse ky buxhet do të duhej të ishte miratuar më herët.

Islam Pacolli kërkoi të dijë se pse nuk është bërë asnjë mirënjohje për investitorët që mundësuan realizimin e projektit të kogjenerimit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:45.

Procesmbajtës:
Zijadin Gashi
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.